



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E APELIT  
VLORE

Nr. 2356/ 1017 Regjistri  
Data 13.04.2016

Nr. 1296 Vendimi  
Data 21.12.2017

V E N D I M

“Në Emër të Republikës”

Gjykata e Apelit Vlorë, e përbërë nga :

<b>ILIBA BEZATI</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>SOKOL NGRESI</b>	<b>Anëtar</b>
<b>MARGARITA BUHALI</b>	<b>Anëtare</b>

Sot në datë 21.12.2017 mori në shqyrtim në shkallë të dytë, çështjen civile që i përket:

**PADITËS:**

[REDACTED] i biri i [REDACTED] i dtl. [REDACTED]  
lindur ne [REDACTED] dhe banues ne [REDACTED]  
[REDACTED] me shtetesi shqiptare, identifikuar me leter  
njoftimin me nr.personal [REDACTED] i perfaqesuar me  
deklarim para gjykates nga av.l. [REDACTED] anetar i dhomes  
avokatisë Fier me license nr. [REDACTED]

**NDËRHYRËSA DYTESOR:**

[REDACTED] e bija e [REDACTED] e  
dtl. [REDACTED] banuese ne [REDACTED]  
[REDACTED] me shtetesi shqiptare e perfaqesuar me  
prokure te posacme nr.3233 rep. Dhe nr.1501 kol.Date  
01.10.2015 nga [REDACTED]

[REDACTED] i biri i [REDACTED] i dtl. [REDACTED]  
banues ne [REDACTED] Lagjia [REDACTED]  
me shtetesi shqiptare, identifikuar me leter njoftimi me  
nr.personal [REDACTED]



RR 268 606 765 AA

[REDACTED] e bija [REDACTED] dtl. [REDACTED]  
banuese ne [REDACTED]  
me shtetesi shqiptare, e perfaqesuar me prokure te posacme  
nr.3233 rep. Dhe nr.1501 kol. Date 01.10.2015 nga [REDACTED]  
[REDACTED]

**E PADITUR:**

Shoqeria "Albpetrol" sh.a. Patos, me seli ne Lagjia "29  
perfaqesuar me autorizim nga [REDACTED] (Ne mungese ne  
shpalljen e vendimit).

**PERSON I TRETË:**

Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi Tirane, meseli ne  
Rr: Sami Frashëri, Nr.10, Kati II, Tiranë e perfaqesuar me  
autorizim nga [REDACTED] (Ne mungese ne shpalljen e  
vendimit).

**OBJEKTI:**

1.Konstatimi i faktit te diskriminimit dhe viktimizimit ndaj  
paditesit,e kryer nga ana e punedhenesit Albpetrol  
sha.Patos.

2. Ndrejten e shkeljeve ligjore dhe pasojave te ardhura, duke  
detyruar punedhenesin Albpetrol sha. Patos, të riktheje paditesin ne  
vendin e mëparshem te punes ne pozicionin e pergjegjesit te turnit  
prane pales se paditur, ose ne nje pozicion te barazvlefshem me  
te.

3.Detyrimin e punedhenesit Albpetrol sha. Patos ta  
demshperbleje paditesin duke e kompensuar per demet pasurore te  
shkaktuara ne formen e fitimit te munguar per mosmarrjen e pages si  
pergjegjese i turnit prane pales se paditur, nga moment i pushimit nga  
puna ne dt.25.07.2014 deri ne rikthimin e tij ne kete pune.

4.Detyrimin e punedhenesit Albpetrol sha.Patos  
të demshperblejë paditesin per demin jopasuror te pesuar.

5. Detyrimin e Punedhenesit Albpetrol sha. Patos te paguaje  
shpenzimet gjyqesore dhe ato te perfaqesimit me avokat.

**BAZA LIGJORE:**

Neni 17/2, 18, 33/1 dhe 49 te Kushtetutes te Republikes se Shqiperise,  
neni 14 i Konventes Europiane e te Drejtave te Njeriut, Nenet 31, 32/a,  
153, 154 te K.Pr.Civile, Nenet 9, 10, 10/1 i K.Punes , Nenet 3, 7, 12,  
13, 34, 36, 37,38 te ligjit Nr.10221 date 04.02.2010 "Per Mbrojtjen nga  
Diskriminimi", si dhe Nenet 608 , 625, 640 te Kodit Civil. Vendimi

unifikues i Gjykatës së Lartë Tirane me nr.12, date.14.09.2007. Vendim i Gjykatës Kushtetuese me nr.6 datë.17.02.2012.

**Gjykata e Shkallës së Parë Fier, me vendimin Nr.240, Date 20.02.2016 ka vendosur:**

1. Pranimin pjesërisht të padisë së paditesit [REDAKTUAR]
2. Konstatimin e faktit të diskriminimit dhe viktimizimit të paditesit [REDAKTUAR] nga ana e pales së paditur "Albpetrol" sh.a Patos.
3. Detyrimin e të paditurit Albpetrol sh.a Patos të dëmshperblejë paditesin [REDAKTUAR] për demin pasuror dhe jo pasuror të pesuar, në shumën 3.665.185. leke brenda një afati kohor prej dy vjetësh.
4. Rrezimin e padisë për pjesët e tjera.
5. Shpenzimet gjyqësore të ngarkohen paleve në perpjestim me pjesën e pranuar dhe të refuzuar të padisë.

### **GJYKATA E APELIT VLORE**

Pasi dëgjoi raportimin e gjyqtarës Ilirja Bezati;

Përfaqësuesin ligjor të palës paditëse Av. [REDAKTUAR] dhe paditesin [REDAKTUAR] që kërkuan ndryshimin e vendimit dhe pranimin e kërkesëpadisë,

të paditurin Albpetrol sh.a i cili kërkoi ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier dhe rrezimin e padisë si dhe ,

Avokaturën e Shtetit që kërkoi prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve për rigjykim.

### **V E R E N**

*Vendimi i Gjykatës së shkallës së parë Fier, Nr.240, Date 20.02.2016 është marrë në zbatim të gabuar të ligjit procedural dhe si i tillë, vendimi duhet të lihet të prishet dhe çështja të dërgohet për rigjykim.*

Nga aktet e ndodhura në dosje ka rezultuar se, Paditesi [REDAKTUAR] ka filluar punë pranë punedhësit Albpetrol sh.a. Patos në 1970 deri në 25 korrik 2014 kur u pushua nga puna, pra ka 44 vite punë pa ndërprerje, pranë punedhësit Albpetrol sh.a. Patos. Sipas Librezës së punës që ndodhet në dosjen gjyqësore, paditesi rezultoi të jetë me arsimin e mesëm 4 vjeçar profesional, me emërtimin "Teknik Naftë", me shkallën e kualifikimit maksimale të kategorisë së "VII", si dhe me titullin "Mjeshtër në Profesion" si teknik naftë, i dhënë ky titull nga vete punedhësi Albpetrol sh.a Patos sipas legjislatcionit në fuqi. U vertetua se paditesi kishte punuar gjatë gjithë kohës në sektorët e prodhimit të naftës në Drenovë, Ballsh, Visok, Marinez, dhe Sheqishtë, pa asnjë shprehje nga Kompania Albpetrol sh.a Patos deri në momentin që e kanë pushuar nga puna ( të gjitha këto janë të parashikuara në Librezën e Punës). U vertetua se paditesi ka punuar në disa

pozicione pune, si Operator Prodhimi, Axhustator, Mjeshter Remonti, Pergjegjes Turri, Drejtues Punimesh, dhe tre vitet e fundit u vertetua te ishte me detyre "pergjegjes turri" ne Q.A.R Patos, qender nen varesi te Albpetrol sh.a. Patos, gjate 44 viteve te pune rezultoi se nuk kam marr asnjeher ndonje mas disiplinore apo verejtje. Pra i kemi vertetuar gjykates se paditesi eshte nje teknik i mesem, eksert ne fushen e naftes me nje eksperience 44 vjecare (asistent-Inxhinier sipas legjislacionit para viteve 1990).

Pala paditese [REDACTED] ishte sindikalist i vjeter ne sektorin e naftes dhe nenshkrues i kontratave kolektive te punes, qe nga viti 1993 e ne vazhdim, sic u vertetua ne gjykim nga kontratat kolektive te punes e fundit me nr.1655 prot, e dt.30.05.2011, lidhur midis punedhenesit Albpetrol sh.a.Patos dhe sindikatave nen cilesine e punemarresit. Sipas VKM-se me nr.132, dt.24.02.2010 dhe urdherit te Ministrit te Punes me nr.549/1, dt.17.03.2010, paditesi ka qene kandidat i Keshillit Kombetar te Punes, me mandat 4 vjevar deri ne 17.03.2014, gjithashtu vazhdon te merrem me aktivitet Sindikal, pra kemi te bejme me nje sindikaliste te vjeter ne sektorin e naftes, i njofur si nga Ministria e Punes nga Keshilli Kombetar i Punes ashtu edhe nga Punedhenesi Albpetrol sh.a. Patos. Mardheniet e punes ne kompanin Albpetrol sh.a. Patos, kur paditesi ishte ne mardhenie pune kane qene te regulluar me Kontraten Kolektive te Punes me nr.1655 prot, e dt.30.05.2011, e cila eshte ende ne fuqi, kontrate ku paditesi rezultoi te ishte nenshkrues ne cilesin e kryetarit te Sindikata Autonome e Ndermarrjeve te Nxjerrjes se Naftes Patos ( i cili eshte edhe sot).

Mardheniet individuale te punes me punedhenesin Albpetrol sh.a. Patos dhe punemarrsin Myrtezan Goxhaj qe nga viti 1970 deri ne momentin e shkeputjes nga puna, kane qene pa afat te percaktuar. Ne qeshor 2012 Z. [REDACTED] ka nenshkruar nje kontrate pune individuale me afat 1 vjecar, por kjo kontrate mbasi kishte mbaruar ne qeshor 2013, ka vazhduar ne heshtje, dhe ne zbatim te K.Punes nenit 149 pika 2 ku eshte parashikuar se : "Kur, mbas përfundimit të afatit të caktuar, kontrata zgjatet në heshtje tej këtij afati, ajo konsiderohet si kontratë me afat të pacaktuar", pra mardheniet mes punedhenesin Albpetrol sh.a. Patos dhe punemarresit [REDACTED] kane qene pa afat te pacaktuar sipas kontrates individuale te punes.

Sic eshte vertetua ne gjykimin ne shkalle te pare, ne kontraten individuale te punes, ne perputhje me nenin 12, dhe nenit 109 te K.Punes dhe Konventa nr.95 "Per mbrojtjen e pagave" eshte e percaktuar pozicionin i punes si "Pergjegjes Turri", Pagen baze prej 48500 leke/muaj dhe pagesen per titullin mjeshter ne profesion ne masen 10 % te pages baze, paga e tij ne total ka qene 53 350 leke/muaj neto. Ne baze te nenit; 420, 690 i Kodit Civil, ku eshte parashikuar se : " detyrimi rrjedh nga ligji ose nga kontrata, dhe kontrata ka fuqin e ligjit per palet, Kontrata Kolektive dhe Individuale e punes lidhur mes meje dhe Punedhenesi Albpetrol sh.a. Patos ka fuqin e ligjit per palet. Me shkresen nr.536 prot. "Albpetrol" sh.a. Patos, ne dt.21.11.2013 i ka dhene paditesit [REDACTED] leje e zakondeshme per vitin 2013 te cilen nuk e kishte bere. Ne kete flete leje citohet se; [REDACTED] ne detyre "Pergjegjes Turri" i jepet leja e zakondeshme". Deri ne kete dt.21.11.2013 paditesi rezulton te kete qene me detyre Pergjegjes Turri, dhe me page baze prej 48500 leke/muaj dhe me orar pune 07:00 – 15:00 (diten pa turme).

Paditesi pasi u kthye nga leja ne dt.09.01.2014, 1. pa nje njoftim paraprak, 2. pa nje marrveshje te shkruar sipas nenit 21 te K.Punes, 3. ne kundershkrim flagrant, me Kontraten kolektive dhe nenin 9 ku eshte parashikuar se kryetaret e sindikates nuk mund te levizen nga vendet e punes pa pelqimin e personit Juridik -Sindikates, 4. ne kundershkrim me neni 181 te K.Punes, Paditesit ju ndryshua vendin e punes, nga Pergjegjes Turri ( drejtues brigade) dhe me orar pune 07:00 – 15:00 (tere ore pune ), ne Roje. Ndryshimi i vendit te punes ndryshoi dhe prishi kontraten

individuale te Paditesit, sepse paditesit [REDACTED] u ul paga 16000 leke/muaj, ju ndryshuan oraret e punes nga ditën 00:07-15:00 ne me turne 12 oraresh, ju ndryshuar profesioni nga teknik ne roje pa profesion etj, keto ndryshime u vertetuan ne gjykim nga ekstrakti i llogaris se pages se paditesit ku u vertetua qe paga neto nga 49000 leke/muaj shkoi 32000 leke/muaj si dhe vertetimi i pages sjell nga Albpetrol sh.a Patos .

Ndryshimi i vendit te punes se paditesit, i pages, i kushteve te punes dhe orareve, ne gjykim u vertetua se nuk kishte asnje marrveshje te shkruar mes paditesit ne cilesin e punemarrest dhe Albpetrolit ne cilesin e punedhenesit, por vetem urdher verbal, dhe ndryshimi nuk ka ardhur per arsye ligjore, por per tu zvendesuar me z. [REDACTED] i cili eshte nipi i z. [REDACTED], shefit te sektorit ku ka punuar paditesi, ne konflikt te hapur interesi me ligjin me nr.9367, dt.07.04.2005 "per parandalimin e konfliktit te interesit ne ushtrimin e profesionit publik" I ndryshuar, sepse nuk mund te pozicionoj nipin e tij ne vendin tim te punes. Gjithashtu ne kete kohe ka filluar pune ne pozicionin e pergjegjesit te turnit z. [REDACTED] pa arsimin perkates te teknikut te naftes te dy personat qe zvendesuar paditesin [REDACTED] u vertetua ne gjykim te ishin te sapofutur ne pune dhe me arsim fillor dhe pa kualifikimin perkates ne karahasim me paditesin . Pra zvedesimi nga vendi i punes si pergjegjes turni i paditesi dhe dergimi i tij te punonte roje, per tu zvendesuar nga [REDACTED] dhe [REDACTED], dhe zvedesimi i nje eksperti nafte me shkolle profesionale dhe titull mjeshter ne profesion me punonjes te rinje me arsim 8 vjecar , perben trajtim te pabarabarte dhe ne kuptim te ligjit quhet dikriminim.

Ndryshimi i vendit te punes se paditesit me [REDACTED] dhe [REDACTED] u vertetuan ne gjykim me librezat e punes se [REDACTED] dhe [REDACTED] dhe kontrata individuale te punes, qe vertetojne se keta dy punonjes jane te sapo marr ne pune ne sektorin ku ka punuar paditesi dhe jane te pozicionuar ne janar 2014 si pergjegjes turni ne periudhen kur u hoq paditesi nga ky vend pune. Albpetrol sh.a Patos ka pas mundesi pune si pergjegjes turni per Paditesin por e ka trajtuar ne menyre te pabarabarte duke e zvendesuar me punonjes te tjere te pa kualifikuar.

Nga stresi, gjendja e ankthit, pasiguria e krijuar nga Punedhenesi Albpetrol sh.a Patos ndaj z. [REDACTED] dhe familjes tij, gjendja e tij shendetsore ne kete periudhe kohe nuk ka qene e mire, dhe eshte trajtuar me 29 dite raport mjekesore nga data 17.03.2014 deri me daten 16.04.2014, sipas modularit te raportit me nr.001005 dhe sipas modularit te raportit me nr.0042080, vertetuar kjo edhe nga epikriza percjellese e spitalit rajonal Fier me nr.1630 e dates 17.03.2014 , epikriza percjellese e spitalit rajonal Fier dhe moduleve te raporteve gjenden ne dosjen gjyqesore dhe jane raporte te paguara nga Albpetrol sh.a Patos . Per paditesin dhe familjen e tij (nderhyresat dytesor ne proces) ju krijua nje gjendje familjare e pazakonte, stress, ankth, merzitje, pasiguri dhe zvogelim i te ardhurave

Ne dt.18.06.2014 deri ne dt.23.06.2014 paditesi ka qene i shtruar ne spitalin rajonal Fier, dhe ka qene me raport deri ne dt.07.07.2014, (pra ka marre 33 dite te tjera raport mjekesor ), gjithsej 62 dite raport per 3 muaj pune.

Specialistet e KLM te spitalit Rajonal Fier, bazuar ne gjendjen shendetsore te paditesit , e kane pajisur ne dt.17.04.2014 me Raport mjekoligjor KLM i konfirmuar ky raport edhe nga spitali "Nene Tereza" Tirane, i cili ka parashikuar per nje afat 1 vjecar nga (dt.30.06.2014-30.06.2015), qe e detyronte Punedhenesin Albpetrol sh.a, te me poziciononte ne pune te lehte me orar te kufizuar dhe e ndalonte qe te punonte me turne. Ne lidhje me legjislacionin ne fuqi, z. [REDACTED] kerkoi ti akordohej ndihme ekonomike nga "Albpetrol" sh.a. sipas Kontrates Kolektive te Punes me nr.1655

prot,e dt.30.05.2011 neni 10 pika dhe sipas VKM-ne, me nr.929, datë 17.11.2010, ndryshuar me VKM-ne me nr.493, datë.06.7.2011, ka parashikuar ne piken 7, por punedhensi Albpetrol sh.a Patos nuk i eshte dhene asnje ndime. Nje tjeter diskriminim eshte vertetuar qe i takonte ndihma ekonomike tashme me vendimin civil me Nr.62-2015-1488-(539), date.24.04.2015 te Gjykates se Rrethit Gjyqsor Fier ne te cilin detyrohet Albpetrol sh.a Patos ti akordoj ndihmen ekonomike z. [REDACTED] (vendim i cili ndodhet ne dosjen gjyqesore).

Ne lidhje me gjendjen shendetsore te paditesit, kur ka qene ne mardhenie pune, qe sipas raportit KML te cituar me siper, duhet te punonte ditën me orar te kufizuar, por sipas shkreses se dores, leshuar nga perfaqesuesit e punedhenesit, paditesi u dergua te punonte me turme ne ambjent te hapur nen presionin e agjenteve atmosferike ne kundertshtim me raportin KML . Kjo ju vertetua gjykates se nuk i eshte zbatuar Raporti KML jo vetem me shkresen e dores e leshuar nga perfaqesues te punedhenesit Albpetrol sh.a qe ndodhet ne dosjen gjyqesore , por edhe sipas porces-verbalit qe ka mbajtur KMD Tirane me Shefin e Kuadrit te Paditesit, z. [REDACTED], nga ky i fundit eshte cituar pretendimi se, nuk ka pasur vend tjeter pune tjeter vecse me turme per paditesin, pra Albpetrol sh.a Patos nuk ka zbatuar asnjehere raportin KML te Paditesit.

Per te gjitha shkeljet ligjore, paditesi nuk i ka pranuar dhe i eshte drejtuar me ankese punedhenesit, ne lidhje me gjithe shkeljet ligjore diskriminimin qe po i ndodhnin , me kerkesen nr.1 e protokolluar prane Albpetrol sh.a. Patos, me nr.3096 prot, dt.08.04.2014 por nuk mori asnje pergjigje zyrtare dhe asnje zgjidhje. Paditesi i ishte drejtuar perseri punedhenesit me ankese, kerkesen nr.2 e protokolluar prane "Albpetrol" sh.a Patos me nr.4428 prot, dt.27.05.2014, duke i bere me dije se ishte hequr nga vendi punes padrejtesishte, nuk i ishte dhene ndihma ekonomike, nuk po i njihej raporti mjeko-ligjor etj etj. Por nuk mori asnje pergjigje zyrtare dhe asnje zgjidhje.

Paditesi nga shkeljet e mesiperme, duke u ndjere ne kushte e disfavorshme te vendosura nga punedhenesi, i eshte drejtuar Komisionerit per Mbrojtjen nga Diskriminimi, Tirane.

Nga ankimi i [REDACTED] Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi me shkresen me nr.537/2, dt.11.06.2014 si dhe me shkresen me nr.738 prot, dt.01.09.2014, i eshte drejtuar Z. [REDACTED], komisioneri ne zbatim te ligjit me nr.10221, datë 04.02.2010 per mbrojtjen nga diskriminimi eshte shprehur me Vendimin me nr.202, dt.09.12.2014, dhe ka vendosur :

*"Diskriminimin e drejteperdrejte te Z. [REDACTED] per shkak te gjendjes shendetsore dhe per shkak te nje grupimi sindikal nga ana e punedhenesit "Albpetrol" sh.a Patos, si dhe konstatimin e deskriminimit per shkak te ankimit te bere prej tij prane KMD Tirane*

*-Konstatimin e diskriminimit ne formen e viktimizimit per shkak te ankimit te paraqitur prane KMD Tirane ndaj "Albpetrol" sh.a. Patos.*

*-"Albpetrol" sh.a. Patos duhet ta ktheje ne vendin e tij te punes si pergjegjes turrni.*

*-"Albpetrol" sh.a. Patos duhet te bej regullimet ligjore brenda afati ligjor 30 ditor".*

*Komisioneri per Mbrojtjen nga Diskriminimi eshte shprehur me vendim qe edhe familjaret e paditesit si znj. [REDACTED] (bashkeshortje e paditesit), dhe [REDACTED] (djali Paditesit) dhe citon se jane diskriminuar ne formen e viktimizimit nga punedhenesi Albpetrol sh.a Patos per shkak te lidhjeve familjare me [REDACTED] sipas :*

KMD Tirane Vendimin me nr.203, dt.09.12.2014 per znj [REDACTED] (bashkeshortja e paditesit)

KMD Tirane Vendimin me nr.164, dt.19.11.2015 per z. [REDACTED] (djali i paditesit).

Pervec KMD Tirane, janë shprehur edhe kater institucione te tjera te shtetit shqiptar, sic eshte KLSH, MEI (Ministria e Energjise dhe Industrise), Avokati Popullit, si dhe vendime gjyqesore, duke vleresuar viktimizim familjar te gjitha veprimet dhe mosveprimet e kunderligjshme te kryera nga punedhësi "Albpetrol" sh.a. Patos ndaj paditesit dhe familjes se tij.

Vendimi 202 i KMD Tirane per [REDACTED] është kundërshtuar perseri nga Albpetrol sh.a Patos me objekt pavlefshmeri absolute dhe Gjykata Administrative e Shkalles se Pare Tirane me vendimin me nr.5295- (80-2015-3568), dt.22.10.2015 ka vendosur rrezimin e kerkesepadise Albpetrol sh.a Patos duke lene ne fuqi vendimin 202 te KMD Tirane. Ne kete vendim Gjykata ka arsyetuar se jane kryer nga punedhësi "Albpetrol" sh.a. Patos veprime dhe mosveprime te kundraligjeshme duke e vendosur Z [REDACTED] ne kushte te pabarabarta nga ato qe ka parashikuar Kushtetuta dhe KNDNJ dhe ligji duke e diskriminuar ate dhe familjen e tij . Pas pushimit nga puna te paditesit dhe familjareve te tij, pas shume muajsh, stresi , gjendje ankthi, pasigurie, shantazhi, presioni psikologjik, te krijuar nga punedhësi "Albpetrol" sh.a. Patos per paditesin dhe familjaraet e tij, paditesi ka pesuar nje goditje kardiake, kjo u vertetua nga epikrizza percjellese, dhe kartela klinike e leshuar nga Spitali Kardiologjik, Gjerman e dt.19.08.2014, ku percaktohet se shkaku i kesaj goditje ishte, tension i larte me natyre stresante si dhe percakton gjendjen e paditesit me dhimbje koke, pagjumesi, marrje fryme, nervozizem i theksuar, rrajhe te shpejta te zemres, gjendje e rende psikologjike e shkaktuar nga stresi i pushimit nga puna, te njejten gje ka percaktuar edhe neurologjia e spitalit Gjerman si dhe psikologjia.

Nisur nga shqyrtimi i fakteve, te provuar ne gjykim, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar paligjshmërine e veprimeve apo mosveprimeve nga ana e "Albpetrol" sh.a., Patos në dëm të [REDACTED] qe ka sjellë për pasojë edhe vendosjen e tij në kushte të disfavorshme, duke filluar që nga transferimi i tij nga një pozicion pune, në një tjetër më pak të favorshëm për të, e deri në largimin e tij nga puna në mënyrë përfundimtare, si pasojë e zgjidhjes së Kontratës së Punës nga ana e punëdhënësit, zgjidhje e cila ka sjellë pasoja negative për palën paditëse. Në kushtet e ekzistencës së shkaqeve të mbrojtura të diskriminimit, siç janë gjendja shëndetësore dhe përkatësia në një grupim sindikal, gjykata e shkalles se pare ka arritur ne konkluzionin se, gjendemi përpara situatës diskriminuese, në formën e viktimizimit, për shkak të moszbatimit nga pala e paditur te vendimit te Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ndaj [REDACTED]

Gjykata e shkalles se pare, duke marre ne konsiderate nje sere elementesh sic jane moshja e paditesit, shkalla e larte e nevojës se perkujdesjes nga i demtuari ne familjen e tij, qenia si kryefamiljar, per shkak te demit te shkaktuar dhe paaftesis se perhershme te 25% te aftesive fizike per pune, prishjen e ekuilibrave familjare dhe sociale, afersine gjinore e tyre me te demtuarin, tronditjen e madhe te marredhenieve familjare, veshtiresite e adoptimit ne ambientet shoqerore e sociale dhe tregut te punes, cenimin e personalitetit te tij dhe gjithe familjes [REDACTED]

ka vleresuar se shperblimi per demin pasuror dhe jopasuror duhet te jene ne masen 3.665.185 leke.

Gjykata gjate shqyrtimit gjyqësor vendosi persëritjen pjesërisht të hetimit gjyqësor, duke administruar aktet e paraqitura në seancë si dhe dëgjo i palët ndërgjyqëse .

Në gjykimin ne shkalle te dyte u paraqit edhe Avokatura e Shtetit me kërkesën e palës së paditur Albpetrol sh.a, si një pale e domosdoshme në kushtet kur vet pala e paditur është një shoqëri tregtare me kapital 100% shtetëror dhe në këtë rast cënohen drejtpërdrejt interesat e shtetit shqiptar në këtë shoqëri. Ndersa, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi eshte subjekt i pavarur.

Në bazë të Vendimit nr.392 datë 08.04.2009 “Per miratimin e rregullores “Per marrëdhëniet e Avokatures se Shtetit me institucionet shteterore dhe entet publike, rolin e avokateve te shtetit ne gjykim si dhe normat e posacme proceduriale”, gjykata e Apelit e cmon te drejtë dhe të bazuar në ligj kërkesën e të paditurit për të thirrur në gjykim Avokaturen e Shtetit.

Në respektim të parimeve proceduriale civile për formimin e një ndërgjyqësie të rregullt mes palëve në kërkimet e tyre është e nevojshme që vendimi duhet të priset e ceshtja te kthehet per rigjykim ne po ate gjykate me tjeter trup gjykues me qëllim që të thirret Avokatura e Shtetit si pjesëmarrëse në këtë proces.

Sa më sipër, Gjykata e Apelit çmon se, për nevojat e garantimit të një procesi të rregullt ligjor dhe të paanshëm kërkohet pjesëmarrja e Avokaturës se Shtetit për të dhënë pretendimet në lidhje me objektin e padisë .

### **PER KETO ARSYE**

Gjykata e Apelit, bazuar ne nenin 466/a të K.Pr. Civile

### **VENDOSI**

Prishjen e vendimit nr. Nr.240, Date 20.02.2016 te Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe dërgimin e çeshjes për rigjykim në po atë gjykatë më trup tjeter gjykues

Vlorë më 21.12.2017

**ANETARE**  
**MARGARITA BUHALI**

**ANETAR**  
**SOKOL NGRESI**  
(kunder)

**KRYESUESE**  
**ILIBA BEZATI**